



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:154791
Datë: 29.01.2024
Numri i dokumentit: 05249719

PPP.nr.2789/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbartimore ndërmjet kreditorit K “I” sh.p.k, me seli në P, Rr. “G.Z” nr..., me numër të biznesit ..., kundër debitores A.M fshati B.E, Komuna P, lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga ana e debitores, kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.2062/20, të datës 25.09.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat V.B në P, jashtë seancës gjyqësore, me datë 29.01.2024. mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i ushtruar nga ana e debitores A.M fshati B.E, Komuna P, ashtu që: **SHFUQIZOHET** Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.2062/20, i datës 25.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat V.B në P, si dhe **PËRFUNDOHET** në tërësi procedura e përmbartimit në këtë çështje.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat V.B në P, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit K “I” sh.p.k, me seli në P, ka lëshuar urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.2062/20, të dt.25.09.2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të faturës nr..., të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve nga fatura e mësipërme, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhërit t’ia paguajë kreditorit shumën prej 1,246.00 €, me kamatëvonesë prej 8%, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit të paraparë ligjor, prapësim ka paraqitur pala debitore. Në prapësimin e ushtruar, fillimisht pretendohet se lidhur me këtë çështje tashmë ekziston një aktvendim i formës së prerë i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i evidentuar sipas shenjës PPP.nr.1003/19, i dt.03.07.2019, i cili i është bashkangjitur shkresave të lëndës. Tutje pala debitore e konteston në tërësi urdhërin përmbarimor, duke e mbështetur prapësimin në dispozitën nga neni 71 par.1.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, me arsyetim se dokumenti në bazë të të cilit është marrë vendimi përmbarues nuk ka tipare të përmbarueshmërisë si dhe në paragrafin 1.4, pasi që ka skaduar afati kohor brenda të cilit mund të kërkohet përmbarimi. Tutje në prapësim theksohet se provat e bashkangjitura nga kreditori nuk konsiderohen dokumente të besueshme, në kuptim të nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Dokumenti i bashkangjitur nga ana e kreditorit nuk përbën titull ekzekutiv, i njejtë nuk është lëshuar nga organi administrativ, nuk ceket ndonjë detyrim që duhet të zbatohet dhe si i tillë sipas debitores nuk ka tipare të përmbarueshmërisë. Krahas pretendimeve të lartëcekura, pala debitore thekson që kërkesat e kreditorit janë të vjetërsuara, në kuptim të dispozitës nga neni 353 par.1 të Ligjit për Marrdhëniet e Detyrimeve. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi dhe të anulohet urdhëri përmbarimor P.nr.2062/20, i dt.25.09.2020.

Përgjigje në prapësimin e ushtruar nga pala debitore ka paraqitur kreditori. Në përgjigje fillimisht theksohet se pretendimi i debitores që kemi të bëjmë me detyrim të parashkruar është i pa bazuar, mbi bazën e argumentit se detyrimi nuk lind duke u bazuar në vitin kalendarik kur studenti e ka shfrytëzuar shërbimin, mirëpo nga momenti kur merret statusi i studentit të vitit përkatës akademik. Në rastin konkret, meqë debitorja ka qenë me status të studentit aktiv, kreditori ka vendosur që në vitin 2020 të kërkojë përmbushjen e detyrimit përmes faturës së rregullt, që rrjedhimisht nënkupton se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës. Tutje pretendohet se pala debitore është regjistruar në Kolegjin "Iliria" në vitin 2013 dhe me rastin e regjistrimit është njoftuar me çmimin e studimeve. Po ashtu, e njejtë është njoftuar se në rast të përsëritjes së vitit të studimeve, nuk obligohet të paguajë përsëri për të njejtin vit, ndërsa që nga viti 2013, i është nënshtruar provimeve 20 herë, për herë të fundit me datë 12 mars të vitit 2015, ndërsa pagesën e fundit e ka bërë me datën 16 dhjetor të vitit 2013. Po ashtu, e ka kontestuar pretendimin e palës debitore se është inicuar procedurë përmbarimore për të njejtin borxh. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitores dhe të mbetet në fuqi Urdhër për Përmbarim P.nr.2062/20, i dt.25.09.2020.

Gjykata pas vlerësimit me kujdes dhe vëmendje të pretendimeve të palës debitore të parashtruara në prapësim, pretendimeve të palës kreditore të parashtruara në përgjigje në prapësim, si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi është i bazuar, mbi bazën e arsyeve si në vijim:

Fillimisht, Gjykata vlerëson se është e arsyeshme për t'iu përgjigjur pretendimit të palës debitore që kemi të bëjmë me çështje të gjykuar. Gjykata konstatoi se në rastin të cilit i referohet e njejtë, (aktvendimi i formës së prerë i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1003/19, i dt.03.07.2019), përmbarimi është lejuar duke u mbështetur në titull ekzekutiv - Vendim të organit administrativ, i cili është vlerësuar se nuk i përmbushë kriteret e kërkuara për tu konsideruar i përshtatshëm për përmbarim dhe si rrjedhojë urdhri përmbarimor është shfuqizuar. Në anën

tjetër, objekt i propozimit për përmbarrim në këtë çështje është fatura nr... Në këtë kuptim, përderisa ekziston dallim i evidentuar sa i përket dokumentit mbi bazën e të cilit është propozuar, respektivisht është lejuar përmbarrimi, nuk mund të themi se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res iudicata).

Dispozita nga 21 e Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (tani e tutje LPP), e cila i referohet bazës juridike për caktimin e përmbarrimit, parasheh që: "*Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*". Në anën tjetër, dispozita e nenit 29 par.1 e LPP-së përcakton llojet e dokumenteve të besueshme, mbi bazën e cilave mund të caktohet përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla, duke përcaktuar se: "*Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3 faturat*". Paragrafi 3 i të njëjtës dispozite përcakton: "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*". Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, ndërsa mungesa e njërit prej tyre, rrjedhimisht ia heqë cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përmbarrim.

Në rastin konkret, propozimi për përmbarrim është paraqitur duke u mbështetur në faturën nr..., të lëshuar nga ana e kreditorit me dt..., në vlerë të përgjithshme prej 1,246.00 Euro. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, fatura e lartëcekur paraqet dokument të lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit pasi nuk e përmban fare nënshkrimin e pranuesit - në këtë rast palës debitore, pra nuk konsiderohet faturë kthyese. Nisur nga një vlerësim i tillë, Gjykatës i rezulton se fatura e lartëcekur nuk është pranuar nga ana e palës debitore, andaj janë të themelta pretendimet e të njëjtës se dokumenti në fjalë nuk i plotëson kriteret e kërkuara ligjore për të shërbyer si dokument mbi bazën e të cilave mund të caktohet përmbarrimi në kuptim të dispozitës nga neni 29 par.1 nënpar 1.3 lidhur me par.3 të LPP-së, rrjedhimisht nuk e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm në kuptim të kësaj procedure.

Dispozita nga neni 43 par.4 e LPP-së përcakton se: "*Përmbarruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarrueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarrueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim*". Mbi këtë bazë, gjykata në rastin konkret vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, sepse është lejuar përmbarrimi mbi bazën e një dokumenti i cili nuk rezulton të jetë pranuar nga ana e palës debitore, andaj duke iu referuar dispozitës së lartëcekur, gjeti se pretendimet e parashtruara në prapësimin e debitorës janë të bazuara, rrjedhimisht vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes së kësaj çështje, mori parasysh pretendimet e kreditorit të parashtruara në përgjigje në prapësim lidhur me faktin se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës dhe se pala debitore është regjistruar në K "I" në vitin 2013 dhe me rastin e regjistrimit është njoftuar me çmimin e studimeve. Po ashtu, e njejta i ka pranuar të gjitha shërbimet nga ana e kreditorit dhe është njoftuar se në rast të përsëritjes së vitit të studimeve, nuk obligohet të paguajë përsëri për të njejtin vit, ndërsa që nga viti 2013, i është nënshtruar provimeve 20 herë, për herë të fundit me datë 12 mars të vitit 2015, ndërsa pagesën e fundit e ka bërë me datën 16 dhjetor të vitit 2013. Në përgjigje ndaj këtyre pretendimeve, Gjykata sjellë në vëmendje faktin se procedura përmbarimore udhëhiqet nga parimi i rigozitetit formal, ku fokusi i vlerësimit përqendrohet vetëm në dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, në kuptim të vlerësimit të përmbushjes së tipareve të cilat kërkohen me ligj. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se posedimi apo lëshimi i një dokumenti – fature, jo domosdoshmërisht paraqet bazë të mjaftueshme për të realizuar kërkesën në të holla në procedurë përmbarimore, pasi për realizimin e një kërkesë të tillë duhet plotësuar në mënyrë strikte kushtet e përcaktuara ligjore me dispozitat e lartëcekura nga nenet 29 par.1 nënpar 1.3 lidhur me par.3 të LPP-së, kushte këto të cilat në rastin konkret nuk janë përmbushur. Përkundër kësaj, pala kreditore nuk ka ndonjë pengesë që pretendimet e ngritura lidhur me ekzistimin e ndonjë borxhi t'i adresojë përmes inicimit të procedurës kontestimore, e cila i takon një procedure të karakterit të ndryshëm nga procedura përmbarimore.

Nga arsyet e elaboruara më sipër, në mbështetje të dispozitave nga nenet 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL-
PPP.nr.2789/20, datë 29.01.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.